Roli i densitometrisë kockore dhe treguesit të mikroarkitekturës trabekulare në vlerësimin e rrezikut për fraktura te të moshuarit

Senada LLUKA [1] Ergeta KTONA [2]

[1,2] Fakulteti i Shkencave Teknike Mjekësore, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë, Shqipëri

Hyrje:

Osteoporoza është një sëmundje kronike e cila nuk shfaq simptoma të dukshme, përveç rasteve kur ndodh një frakturë.Vlerësimi i rrezikut për fraktura kërkon marrjen në konsideratë të densitetit mineral kockor(BMD)dhe faktorëve të tjerë që lidhen me rezistencën kockore. Dual-Energy X-ray Absorptiometry(DXA), është metoda gold standard për matjen e densitetit mineral kockor .Megjithatë, BMD-ja nuk pasqyron e vetme të gjitha aspektet e rezistencës kockore. Trabecular Bone Score(TBS), i përftuar nga analiza e teksturës së imazhit DXA të shtyllës lumbare, ofron informacion plotësues mbi mikroarkitekturën trabekulare. Së bashku me instrumentin FRAX vlerëson probabilitetin 10-vjeçar të frakturave mbi bazën e faktorëve klinikë të rrezikut, me ose pa përfshirjen e BMD-së së qafës së femurit. Ky rishikim synon të analizojë vlerën plotësuese të këtyre metodave në vlerësimin e rrezikut për fraktura te të moshuarit.

Metodat:

U realizua një rishikim narrativ i literaturës shkencore, me fokus në përdorimin e DXA-së, TBS-së dhe FRAX-it në vlerësimin e rrezikut për fraktura te të moshuarit. U analizuan studimet mbi marrëdhënien ndërmjet densitetit mineral kockor dhe mikroarkitekturës trabekulare, si dhe rolin plotësues të TBS-së në përshtatjen e probabilitetit të frakturave të vlerësuar nga FRAX-i.

Rezultatet:

Literatura tregon se TBS ofron informacion plotësues ndaj BMD-së dhe mund të ndihmojë në identifikimin e individëve me mikroarkitekturë trabekulare të dëmtuar, edhe kur BMD-ja nuk tregon rrezik të lartë. Përshtatja e FRAX-it me TBS mund të ndryshojë probabilitetin 10-vjeçar dhe të përmirësojë stratifikimin e rrezikut në disa individë, veçanërisht kur BMD-ja dhe faktorët klinikë nuk japin vlerësim të njëjtë. Megjithatë, TBS nuk zëvendëson DXA-në ose FRAX-in dhe duhet interpretuar së bashku me të dhënat e tjera klinike.

Përfundime:

Vlerësimi i kombinuar i DXA-së, TBS-së dhe FRAX-it mund të ofrojë një kuadër më gjithëpërfshirës për vlerësimin e rrezikut për fraktura. Kjo qasje mund të mbështesë identifikimin e individëve që kërkojnë vlerësim të mëtejshëm dhe vendimmarrjen klinike për parandalimin e frakturave te të moshuarit.

Fjalë kyçe: DXA, TBS, FRAX.